



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 885/2 Prot.

Vlorë më, 31.03.2026

VENDIM

Nr. 14, datë 31.03.2026

PËR

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË PËRDITËSUAR TË SENATIT
AKADEMIK TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE**

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja d, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; nenit 19, pika 1, gërma dh, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; nenit 13, pika 22 të Rregullores së Brendshme të UV-së; si dhe duke iu referuar relacionit juridik nr. 879 prot., datë 30.03.2026, të përcjellë nga Sektori Juridik, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 31.03.2026,

VENDOSI:

1. Të miratojë në tërësi dhe nen për nen Rregulloren e përditësuar të Senatit Akademik të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi, i cili është pjesë përbërëse e tij.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohen të gjitha dispozitat e mëparshme që bien ndesh me të.
3. Ngarkohen anëtarët e Senatit Akademik, Sekretari Administrativ dhe Sekretari Teknik të Senatit Akademik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim i përcillet Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmëse Akadematike, për shpallje në faqen web të vendimit dhe për realizimin e njoftimeve përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK
PROF. ASOC. DENADA SOTA**

